



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE PA1 Nr.08-253 3.8.2023 Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 83 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele – LSHMAAV („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga Ligji i njëjtë, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrativ („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-253 datë 20.7.2023, për inicim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.08-253 datë 31.7.2023, për vendimin e heqjes së lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive IRIS SHPK Shtip, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-2966/2 datë 1.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të mbajtur më 1.8.2023 miratoi:

Vendim për marrjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip

1. I HIQET leja për transmetim televiziv, nr.08-902 datë 8.7.2015, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip, për shkak se zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetimin e shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera.
2. Ky vendim publikohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, në uebfaqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Ky Vendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) televizioni IRIS SHPK Shtip, është zotërues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-902 datë 8.7.2015, për transmetim nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik i cili nuk shfrytëzon resurs të

kufizuar, në nivel rajonal, për zonën e D3 – Turtel (Shtip, Karbincë, Zrnovc, Çeshinov – Oblesh, Probishtip, Koçanë, Makedonska Kamenicë, Dellçevë, Vinicë, Pehçevë dhe Berovë), shërbime programore televizive me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhëm maqedone.

Në pajtim me nenin 68 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), lejen e transmetimit në televizion dhe radio e jep Agjencia, për nivel të caktuar të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal), ndërkaq zotëruesi i lejes fiton të drejtën e transmetimit të shërbimit programor në radio ose televizion në zonën për të cilën ka marrë lejen.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga Ligji i njëjtë, Agjencia do të marrë lejen e transmetimit në radio dhe televizion para përfundimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i transmetuesve, paraprakisht duke i dorëzuar njoftim me shkrim derisa zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetimin e shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, për punën e botuesve të medias në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Mediat, LSHMAAV dhe dispozitave miratuar nga Ligji i njëjtë (neni 29 paragrafi (1) të LSHMAAV).

Në nenin 27 paragrafi (4) të LSHMAAV parashihet që Agjencia kryen mbikëqyrje të jashtëzakonshme, e cila kryhet në bazë të iniciativës së parashtruar nga organet shtetërore, persona juridik ose fizik, si dhe në rast të dyshimit sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.

Më 12.7.2023, SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip drejtuar Agjencisë dorëzoi Shkresë (PA1 nr.03-189), në të cilën ndër të tjera thuhet se për shkak të gjendjes së rëndë financiare SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip nuk ka mundur të transmeton program televiziv, si dhe të përmbush detyrimet ligjore. Ndaj transmetuesi njofton se po e kthen lejen për transmetim televiziv. Agjencia më 18.7.2023, ka dorëzuar Njoftim drejtuar SHTR televizionit IRIS SHPK Shtip në lidhje me Shkresën e lartpërmendur në të cilën ka njoftuar transmetuesin se çfarë duhet të dorëzon nëse ndërpret me transmetim të programit televiziv.

Në bazë të Shkresës (PA1 nr.03-189 datë 12.7.2023) nga transmetuesi, dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare, Sektori për mbështetje informatike dhe çështje të përgjithëshme në Agjencion më 20.7.2023, drejtuar Drejtorit të Agjencisë dhe Këshillit të Agjencisë dorëzoi Shënim zyrtar (PA1 nr.08-246) me të cilën njofton se Sektori, përkatësisht Njësia për Mbështetje Informatike dhe Teknologjike ka kryer kontroll (inspektim) të TIK sistemit për monitorimin e shërbimeve në radio dhe në televizion dhe gjatë kontrollit është konstatuar se SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip nuk ka transmetuar program më shumë se 90 ditë, si afat i përcaktuar për ruajtjen e regjistrimeve të transmetuesve në nivel rajonal, me të cilin janë plotësuar kushtet nga neni 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga LSHMAAV për marrjen e lejes (zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera).

Në pajtim nga sa mësipër, Sektori për mbështetje informatike dhe çështje të përgjithëshme drejtuar Drejtorit të Agjencisë i ka dorëzuar Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative të kryer më 19.7.2023, të jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare mbikëqyrje administrative (ark.nr.03-2910/1 datë 20.7.2023), ndërsa periudha e përfshirë nga mbikëqyrja ishte 20.4.2023, deri më 19.7.2023. Në Raportin me shkrim të cituar thuhet se me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme administrative ndaj shërbimit programor televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, realizuar në periudhën nga 20.4.2023, përfshirë këtu dhe 19.7.2023, është konstatuar se SHTR televizioni IRIS SHPK

Shtip, më shumë se 30 ditë nuk transmeton shërbim programor televiziv, që paraqet bazë për marrjen e lejes për transmetim televiziv, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV. Në raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative (ark.nr.03-2910/1 datë 20.7.2023), në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 83 të LSHMAAV, është dhënë propozim-masë që drejtori i Agjencisë të paraqesë propozim drejtuar Këshillit të Agjencisë për inicim të procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, PA1 nr.08-902 datë 8.7.2015.

Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV është përcaktuar se nëse konstatohet parregullsi, shkelje ose mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, të miratuara me ligj, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë, kundër botuesi të medias, Këshilli i Agjencisë mund të marrë masë – marrjen e lejes.

Procedurën e marrjes së lejes së transmetimit të radios ose të televizionit, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjëndjen faktike të konstatuar dhe nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, i cili përshkruan se nëse zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetimin e shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare, dhe arsye të tjera dhe e njëjta është bazë për marrjen e lejes në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga Ligji i njëjtë, drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajçevski, në bazë të nenit 83 paragrafi (1) të LSHMAAV, e në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dorëzoi Propozim PA1 nr.08-253 datë 20.07.2023 për inicimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 08.07.2015.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 24-të mbajtur më 21.7.2023, me Konkluzionin, ark.nr.02-2911/2 datë 21.7.2023, e miratoi Propozimin, PA1 nr.08-253 datë 20.7.2023, për inicimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, paraqitur nga propozuesi, drejtori i Agjencisë.

Në lidhje me procedurën e inicuar për marrjen e lejes të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia i dërgoi njoftim transmetuesit në fjalë PA1 nr.08-253 datë 25.7.2023, në të cilin theksohet se nëse menjëherë nuk harmonizon punën e tij dhe fillon me transmetimin e programit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit të Agjencisë, PA1 nr.08-253 datë 20.7.2023, do të marrë vendim për marrjen e lejes për transmetim televiziv, sipas nenit 85 paragrafi (2) të LSHMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.08-253 datë 25.7.2023, Agjencia i'a dërgoi SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip në formë të shkruar përmes postës elektronike. Duke pasur parasysh se drejtuar Agjencisë deri në momentin e miratimit të këtij Vendimi, nuk është dorëzuar letër kthyesë (përgjigje) nga SH.A Posta e RMV-së për pranim të Njoftimit (PA1 nr.08-253 datë 25.7.2023), Agjencia ka krye kontroll në sistemin elektronik – përcjellja e dërgesave të SH.A Posta e RMV-së përmes të cilit kontrollohet statusi i dërgesës, gjatë të cilit është konstatuar se njoftimi i cituar i është dorëzuar transmetuesit më 27.7.2023. Gjithashtu, Njoftimi PA1 nr.08-253 datë 25.7.2023, është dërguar edhe në formë elektronike në adresën zyrtare elektronike të transmetuesit të regjistruar si informacion kontakti në Regjistrin Qendror të RMV-së, si dhe në adresat elektronike të evidentuara në regjistrin e transmetuesve të Agjencisë.

Gjithashtu, më 31.7.2023, sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit drejtuar Këshillit të Agjencisë dhe personit të autoizuar për zëvendësim të Drejtorit të Agjencisë (sipas Autorizimit ark.nr.03-2639/1 datë 27.6.2023) ka dorëzuar Njoftimin

ark.nr.08-253 për punën e SHTR televizionit IRIS SHPK Shtip, në të cilën thuhet se Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të mbajtur më 18.5.2023, për shkak të mospërbushjes së obligimeve nga neni 15 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Media (LM), transmetuesit i ka shqiptuar masë – vërejtje dhe e ka urdhëruar që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit për ndërmarrje të masave të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LM. Aktvendimet për ndërmarrje të masave – paralajmërim janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit, por i njëjti edhe pas skadimit të afatit më (21.7.2023) transmetuesi nuk e ka harmonizuar punën e tij në pajtim me LM. Në pajtim me nenin 15 paragrafi (6) të LM, nëse botuesi i medias brenda afatit shtesë nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara me këtë nen, atëherë janë plotësuar kushtet që organi rregullator kompetent të heq lejen për transmetim në radio ose televizion në përputhje me LSHMAAV.

Për të përcaktuar nëse transmetuesi ka respektuar dispozitat e LSHMAAV dhe ka filluar transmetimin e programeve televizive, Sektori për mbështetje informative dhe çështje të përgjithëshme më 28.7.2023, ka kryer kontrollin, sipas detyrës zyrtare të Agjencisë mbikëqyrje administrative në shërbimin programor televiziv të SHTR televizionit IRIS SHPK Shtip, gjatë të cilit është përpiluar Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-2964/1 datë 28.7.2023, në të cilën është konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk e ka harmonizuar punën e tij, përkatësisht nuk ka filluar me transmetim, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV. Në raportin e cituar është dhënë propozim masë – Drejtori i Agjencisë t'i paraqesë propozim Këshillit të Agjencisë për marrjen e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizionit IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit, të fillojë procedurën për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Duke pasur parasysh faktin e verifikuar se zotëruesi i lejes nr.08-902 datë 8.7.2015 - SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit të Agjencisë PA1 nr.08-253 datë 20.7.2023 nga ana e Këshillit të Agjencisë, nuk ka mënjeluar shkeljen e nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga Ligji i njëjtë, në pajtueshmëri me Propozimin PA1 nr.08-253 datë 31.7.2023 për miratim të vendimit për marrje të lejes për transmetim televiziv të SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip nga Drejtori i Agjencisë dhe Konkluzionin e Agjencisë, ark.nr.02-2966/2 datë 1.8.2023, miratoi Vendim me të cilën i mirret leja për transmetim televiziv SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, për faktin se zotëruesi i lejes ka ndërprerë transmetimin e shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera, që paraqet bazë ligjore për marrjen e lejes në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga Ligji i njëjtë.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMAAV, Vendimi për marrjen e lejes për transmetim në radio ose televizion është përfundimtar, ndërkaq kundër këtij vendimi, zotëruesi i lejes ka të drejtë që të parashtrojë padi para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes, SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit adminstrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.